

VENDIM
Nr.779, datë 14.5.2008

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.589, DATË 5.9.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR RUAJTJEN DHE SIGURIMIN E OBJEKTEVE MË TË
RËNDËSISHME SHTETËRORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, shkronja “dh”, e 129 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në lidhjen 1, që i bashkëlidhet vendimit nr.589, datë 5.9.2007 të Këshillit të Ministrave, pas numrit rendor 10, shtohen numrat 11 e 12, me këtë përmbajtje:

“11. Qendra e Fizikës Bërthamore të Zbatuar, pjesë e Universitetit të Tiranës, Fakultetit të Shkencave të Natyrës.

12. Rafineria e Ballshit, e cila do të ruhet dhe sigurohet nga Policia e Shtetit deri më 30.6.2008.”

2. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare

KRYEMINISTRI
Sali Berisha